Odredjujući kategoriju lica na koje se odredbe ovog zakona odnose, predlagač unosi kriterijum «lica sa stalnim boravkom na Kosovu», član 1. stav 3, a kasnije ga izjednačava sa isntitutom prebivališta, član 3. stav 1. U objašnjenju nadležnog Ministarstva se kaže: «da se prebivalište dokazuje ličnom kartom UNMIK-a». Očigledna je namera predlagača da se iz kategorije uživalaca ovih prava na penzije isključe raseljena lica sa Kosova i metohije, kao i sasvim sigurno jedan broj prisutnih lica na Kosovu i metohiji koji ne poseduju izdatu ličnu kartu od strane UNMIK-a.

Ka i drugim primerima u tekstu ovog zakona, ponovo se predvidjaju ikriminacije koje su kao dela predvidjena krivičnim zakonodavstvom. Ovim zakonom se za pojedina dela predvidjaju izuzetno... izrazito strožije kazne, što stvara pravnu nesigurnost gradjana i stvara problem primene principa blažeg zakona za učinioca.

Ustavnim okvirima, želim da naglasim za privremenu samoupravu, nije predvidjeno da privremene institucije na Kosovu mogu donositi krivično pravne propise.

Dakle šta na kraju znači odredba člana 14. koji kaže: «da stupanjem na snagu ovog zakona prestaje da važi svaka odredba primenjivog zakona koja je u suprotnosti sa ovim zakonom». Ovakva odredba može da se različito tumači, pa samim tim i da omogući zloupotrebe i kršenje odredbe Ustavnog okvira.

Iz prethodno dakle iznetog, Koalicija «Povratak» neće biti protiv, ali će biti uzdržana po pitanju glasanja o ovom zakonu. Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Ky është qëndrimi juaj. Besoj se deputetët kanë të drejtë të deklarohen s ecili për se cilin a mendament. T omë, n ë emër t ë komisionit. S 'do t ë dëshiroja të zgjasim bisedën më tepër. Urdhëroni... Deputeti Tomë Hajdaraj.

TOMË HAJDARAJ:

Unë tash, edhe pse deputetja e cila ishte para meje është kryesuese e këtij Komisioni dhe unë po dal tash në emër të Komisionit dhe mendoj se kam të drejtë. Por, fundi i fundit, kam të drejtë edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në radhë të parë, ky ligj është me të vërtetë i bazuar në bazën dhe ka bazueshmërinë edhe në kushtetutë edhe... Sa i përket pjesës që kemi punaur si Komision, unë mendoj se ajo çka u tha më parë, është votuar dhe mendoj se është demokratike dhe nuk do të thotë se çdo gjë që votohet të votohet unanimisht se atëherë po tutem mos po bëhemi komunistë. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Vazhdojmë në shqyrtimin e drejtpërdrejta të amendamenteve të propozuara.

Amendamenti 1, janë dhënë dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Koalicioni «Kthimi» pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Vë në votim amendamentin 1 nën a).

Kush është për?

Kush është kundër?

A ka abstenime? 1.

Kundër janë 14, abstenim 1. Konstatoj se kalon amendamenti me propozimin nën a).

Amendamenti 2, Koalicioni «Kthimi», me përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër?

Abstenime?

Konstatoj se kalon amenamenti.

Amendamenti 3, Koalicioni «Kthimi», pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

17 për. Mund të konstatojmë se amendamentin nuk kalon.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për?

Kush është kundër?

A abstenon kush?

Kalon amendamenti.

Urdhëro, Hydajet. Kjo u votua, por nëse keni në parim diçka.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryesues, kolegë deputetë,

Unë ju kërkoj falje që po dal kështu pasi u votua post festum por unë kërkova fjalën në fillim, por si duket s'u kuptuam.

Nuk kam asnjë vërejtje në thelbin e kësaj, mirëpo ne zëvendësuam fjalën «i themeluar» me shprehjen «formon». Në tekst kjo do të dilte: Komisioni mjekësor nënkupton një komision të përbërë prej ekspertëve mjekësor, formon në Kosovë nga ministria me qëllim të këshillimit», kështu që është krejt e pakuptimt. Prandaj, duhet të thuhet pra «i formuar» dhe të përshtatet. Përndryshe, del krejt e pakuptimt. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

«I formuar» mund të jetë. Ajo çështje mund të rregullohet. Ju falemnderit.

Amendamenti 5, kemi dy propozime:

Në emër të Komisionit, urdhëroni. Deputeti Gani Koci.

GANI KOCI:

Zoti kryesues,

Komisioni për buxhet ka shqyrtuar amendamentin e Ismajl Kurteshit në nenin 1 pikë 5 dhe ka kërkuar nga Komisioni për legjislacion që të dalë me një qëndrim se ku përfshihet kategoria e personave me aftësi të kufizuar që janë nën moshën 18 vjeçare. Ne nuk kemi marrë atë sqarim, prandaj kjo pjesa e dytë ku thuhet se «persona me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar, konsiderohen edhe personat nën moshën 18 vjeçare. Si Komision në parim e kemi përkrahur këtë dhe kemi kërkuar që kjo kategori, edhe nga propozuesi i Projektligjit, ku përfshihen parimisht personat nën moshën 18 vjeçare janë nën përkujdesje të prindërve ose të kujdestarit ligjor dhe nëse ligji mbi marrëdhëniet familjare e rregullon këtë kategori, atëherë ne do të mund të pajtoheshim që kjo të mos futet në këtë Projektligj, por në qoftë se nuk futet në një ligj tjetër kjo kategori e personave që duhet të mbikëqyret, atëherë si Komision kemi shprehur mendimin se duhet të përfshihen në këtë ligj këta persona sepse edhe këta janë persona me aftësi të kufizuar.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

A do të thotë kjo se heqni dorë nga amendamenti nën a)?

GANI KOCI:

Ne do të hiqnim dorë nga ky amendament, në qoftë se propozuesi i këtij Projektligjit ka llogaritur ose ka menduar se në një ligj tjetër, qoftë atë për marrëdhënie familjare, do të përfshihet kjo kategori e personave të paaftë, që do të kenë një përkujdesje të veçantë ligjore.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, një sqarim. Çështja hipotetike se çka do të ndodhë më vonë, është problem krejt tjetër. Cili është qëndrimi i Komisionit rreth kësaj variante, e para ose e dyta?

GANI KOCI:

Qëndrimi i Komisionit rreth kësaj variante është që kjo kategori të përfshihet në ligjin e propozuar.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Domethënë jeni për b). Si anëtar i Komisionit mundeni, urdhëro mund të marrësh fjalën, por nuk është në rregull.

ILAZ PIREVA:

Një shpjegim këtu lidhur me këtë amendament. Duhet patur parasysh se ky ligj bën pjesën në strukturën e ligjeve – skema e ndihmës sociale, pensioni themelor ekzistues dhe skema e invalidëve të luftës, që është me një rregullore të UNMIK-ut, prandaj ky vetëm përmbushë ose përplotëson këtë strukturë.
Si duket nuk nuk e kanë patur këtë skemë të ndihmës sociale, sepse atje janë sendet krejt të rregulluara për të gjitha kategoritë. Prandaj, asnjë kategori nuk mbetet jashtë përkujdesjes të institucioneve apo ligjore duke u nisur prej moshës më të re deri në atë më të vjetër.

Vetëm sa për sqarim. Kjo kategori që tha zoti deputet Gani Koci, duhet shikuar te skema e ndihmës sociale «persoan të varur» dhe aty çdo gjë është e rregulluar, kështu që asnjë kategori, sepse e kemi edhe një kërkesë të një shoqate «Nëna dhe famia» të cilët kanë bërë një kërkesë nga ky Kuvend të jepen shpjegime, do të thotë ky është ajo që asnjë kategori nuk mbeten jashtë ligjit. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Po procedojmë. Këto janë sqarime në kuadër të Komisionit. Urdhëro, Hasan.

HASAN META:

Unë, sa e kam kuptuar këtë nën b), deputetit Ismajl Kurteshi ka plotësisht të drejtë. Nëse bëhet fjalë për kompensime për persona me aftësi të kufizuara atëherë hyjnë të gjithë personat e lindur deri në vdekje. Dhe, mos e gjuani apriori këtë. Ajo çka futet nëpër tjera – ndihma sociale e tjera, nuk bën fjalë për persona me aftësi të kufizuara. Logjika është dhe duhet ta pranojmë këtë nën b). Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, shkojmë më tej, ju lutem. Urdhëroni, propozuesi Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Kryesi e nderuar, deputetë të nderuar,

Unë vetëm një herë do të jap sqarime, nuk do të dal amendament për amendament nga tetë sa i kam propozuar, prandaj ju lus për pak durim.

S'pari do të dëshiroja të them se këto amendamente i kam hartuar në bashkëpunim me Degën e Hendikosit në Gjilan dhe shum prej tyre janë shqetësime të tyre dhe ata kanë dhënë kontribut të madh në këtë drejtim dhe besoj se do të duhej të kihet parasysh kjo çështje. Çështje tjetër, qëllim i këtyre amendamenteve është që atyre në një formë t'iu krijojmë disa lehtësi dhe një qëllim tjetër është precizimi i disa çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ligj.

Sa i përket amendamentit për të cilin o bëhet fjalë, në propozimin tim thuhet: «persona me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar konsiderohen edhe personat

nën moshën 18 vjeçare, pasi që, sipas ligjit, kjo kategori ka mbetur e papërcaktuar dhe në ndonjë rast ata futen në kategorinë e anëtarëve të familjeve që kanë nevojë për ndihmë sociale» dhe sipas mendimit tim unë konsideroj se kjo nuk është e drejtë prandaj, unë tash po kaloj në amendamentin e 16....

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, zoti Kurteshi, mos të dalësh, sepse ka shkapërderdhje të materies pastaj. Në amendamentin e parë, tash në të pestin, janë dy propozime, dhe është edhe propozimi juaj. Keni preferencën konkrete sipas kësaj që kemi dhënë. Kur të vjen fjala për amendamentin konkret, mund të shkojmë dhe bisedojmë, s'ka kurrfarë problemi, sepse bëhet shkapërderdhje.

ISMAJL KURTESHI:

Nëse më lejoni, këto dy amendamente lidhen njëra me tjetrën...

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Lidhen, por e jepni sqarimin më vonë prap, të lutem. Të falemnderit.

Megjithatë, këtu sado që kishte një kombinim, janë dy propozime. Propozimi i parë është nën a) i Komisinit me përkrahje nga Komisioni i buxhetit, por me një ndërhyerje që s'është korrekte në këtë fazë, sepse duhet të bëhet tërheqja apo duhet të mbeteni në qëndrimin tuaj dhe propozimi b) ky amendament i propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për variantin a)...

Urdhëro, Hydajet. Për çfarë është fjala. S'janë tri! Tri s'munden me hy tash, ju lutem.

HYDAJET HYSENI:

Unë përsëri po tërheq vërejtjen në ecurinë e shqyrtimit. Këtu janë në të vërtetë dy çështje të ndryshme. Amendamenti i Komisionit funksional dhe Komisionit të buxhetit ka të bëjë me zëvendësimin e një shprehjeje. Dhe, kjo është..., nuk mund ta absolvojë ose ta përjashtojë propozimin e zotit Kurteshi që kërkon të shtohet një pjesë e veçantë. Prandaj, mendoj e duhet të votohen të dyja si dy amendamente të veçanta. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Kjo variantë që të votohen të dyjat me shtesë, nëse Komisioni i buxhetit ka qëndrim të tillë paraprak, është në rregull.

Atëherë kush është për pjesën e parë dhe pjesën e dytë në bashkëngjitje, pra sipas amendamentit të thënë... Urdhëro, kryetari i Komisionit të buxhetit, edhe një sqarim e dua prej teje, të lutem.

E ka fjalën Haki Shatri, kryetar i Komisionit të buxhetit.

HAKI SHATRI:

Të falemnderit. Të nderuar kolegë,

Mendoj se është mirë ta përqëndrojmë vëmendjen këtu dhe mos të nxitojmë shum. Ashiqare shihet se amendamenti i propozuar nga Komisioni funksional për nenin 1.5 dhe amendamenti i propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi nuk vijnë në kundërshtim dhe në parim mund të votohen të dyjat, sepse amendamenti i Komisionit funksional nuk është përmbajtje që duhet ose njëri ose tjetri... Amendamenti mund të përkrahet edhe i Komisionit funksional dhe mund të përkrahet edhe pjesa që është thënë të mirret mendimi në qoftë se nuk është në kundërshtim me ndonjë ligj tjetër, ku shtohet pika 1.5 – teksti dhe asesi nuk kundërshtohen.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Urdhëro, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Zoti kryesues, deputetë të nderuar,

Ju lutem, keni përgjegjësinë për vendimet që i keni marrë. Mos hiqni dorë pa lidhje nga ato që i keni formuluar si Komision dhe keni rezon çka keni bërë dhe çka po lypni.

Në ndërtimin e amendamenteve ju mund të bëni amallgame – jo mund të ndërtohen dyjat. Po, ashtu s'duhet të votohet. Duhet të votohet strikt qysh është me dy variantat, pa marrë parasysh përmbajtjet. Sepse, i sygjeroj kryetarit të Komisionit

të buxhetit, që foli para meje – bashkë me logjiken, ju atëherë keni pasë logjikë sepse ka implikime buxhetore, zotni, kjo që e keni.... Por, ju po harroni ndoshta që ka. Dhe, ju nëse keni thënë se ka implikime buxhetore, keni të drejtë. Tash, nëse thoni s'ka – s'keni drejtë hiq.

Kështu që, ju lutem shum, s'ka kurrfarë arsyeje të mos votohen kështu si janë dhe deputetët le të shprehin mendimin e vet. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Ivanoviq, anëtar i Kryesisë.

OLIVER IVANOVIĆ:

Kolega Hamiti je odprilike rekao većinu onog što sam ja hteo da kažem. Znači, ne možete ovde pred nama sada da spekulišete: hoćete da podržite - nećete da podržite! Za nas je važno da predsednik Komisije eksplicitno kaže – podržavam amandman ili ga ne održavam, jer to ima uticaj na nas poslanike ovde i vi ćete na osnovu toga glasati.

I druga stvar je, govorio je mislim kolega Koci u prethodnom svom izlaganju. Ne možemo da razmišljamo i da uslovljavamo pojedine amandmane time šta bi se moglo dogoditi unapred. Dobra je vaša napomena jer će to sigurno uzeti u obzir onaj koji je predlagač zakona, ali ne više od toga. Znači, vaš stav mora da bude isključivo vezan za ovu temu.

Ja znam da ova dva amandmana nisu medjusobno suprostavljena, ali prvi je podržala Komisija za budžet, kao Komisija koja bi o tome morao da vodi računa, a drugi očigledno nije. I samo je važno da predsednik Komisije jasno kaže da podržava taj amandman, odnosno ne podržava kao što piše, ili su u medjuvreme kao Komisija promenili svoj stav. A onda moramo da znamo i zašto. Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

T'falemnderit. Mendoj se është kemi mundësi të vazhdojmë, me një vërejtje për punën e mëtejshme të komisioneve edhe në këtë fushë.

Kush është për variantin a) të propozuar nga Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit?
Kush është kundër?

A ka abstenime?
Konstatoj se kalon amendamenti nën a).

(Hasan Meta, prej vendi: Zoti kryesues, nga vendi deshta diçka... Është shum me rëndësi. Implikimet buxhetore janë shum ... më i vogël se sa të përjashtohet prej kategorisë, prej kësaj kategorie.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Jo nga vendi nuk bën, më fal. Të lutem, zoti Meta s'ta kam dhënë fjalën.

Amendamenti 6, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për?

Kush është kundër?

A ka abstenime?

Konstatoj se kalon amendamenti sipas variantit të ofruar.

Amendamenti 7, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për?

(Sabri Hamiti, prej vendi: Shpjegim. Unë mendoj se pasi janë... qëndrime, mendoj se duhet me na i shpjegue me dy fjalë...)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Po, nëse ka nevojë. Kryetari i Komisionit të buxhetit, lus për shpjegime në përkrahje.

(Haki Shatri, prej vendi: Mirë është profesor, mirë!)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, edhe një herë, meqë nuk u sqarua sa duhet çështja e votimit. Të deklarohemi.

Kush është për? Ju falemnderit.
Kush është kundër?

A abstenon kush? 3 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

Astenime?

Konstatoj se kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Koalicioni «Kthimi» pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

Urdhëroni. E ka fjalen deputetja Petkoviq, kryetare e Komisionit.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Jedno objašnjenje zašto smo predložili amandman i da se vežemo baš za datum 1.1.1998. Datum koji je predvidjen u amandmanu predstavlja uslov za sve gradjane Kosova kojima je dato biračko pravo, tojest pravo da glasaju. I ako smo to prihvatili prilikom glasanja, osnovno je znači da možemo da prihvatimo i kao uslov za sticanje prava, znači za naknadu sa ograničenu sposobnost. Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

T'falemnderit në sqarime. Dëgjuam sqarimin.

Edhe një herë – kush është për amendamentin e propozuar nga Koalicioni "Kthimi" pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet krysore?

Të numërohen votat, ju lutem.

Konsideroj se nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër?

Abstenime?

Konsideroj se kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A është kush kundër?
A abstenon kush? 15 abstenime.

Konsideroj se kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër?

Abstenime? 15 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër?

Abstenime? 15 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? 9 janë për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? 16 për.

Nuk kalon amendamenti.
Amendamenti 16, deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Urdhëroni zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Në këtë amendament, konsideroj se janë diskriminuar personat që janë anëtarë të familjeve që marrin ndihmë sociale. Në pikën 3.6 të nenit 3, thuhet: "Personat që janë të përfshirë si anëtarë të familjes me qëllim të përcaktimit të shumës së pagesave të ndihmës sociale, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionet e aftësisë së kufizuar" dhe në propozimin tim është kështu: "Personat që janë të përfshirë si anëtarë të familjes, që kërkojnë ndihmë sociale, me qëllim të përcaktimit të shumës së pagesës të ndihës sociale, duhet të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar sepse pensioni i aftësisë së kufizuar është e drejtë individuale, ndërsa ndihma sociale është e drejtë familjare, por personi në fjalë nuk do të duhej të llogaritet në numrin e gjithmbarshëm të anëtarëve të familjes që kërkojnë ndihmë sociale". Dhe, këtu do të dëshiroja të them një gjë. Nëse ky amendament ka ndonjë implikim, atëherë ka implikim buxhetor. Komisioni buxhetor e ka përkrahë, Komisioni funksional nuk e ka përkrahë. Unë konsideroj se Komisioni funksional në këtë rast i ka kaluar amendamentet shpejt e shpejt pa i analizuar mirë dhe për mua është kjo e pakuptueshme, prandaj kërkoj sqarim nga kryetari, ose ndonjë anëtar i Komisionit - pse është refuzuar ky amendament nga Komisioni. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, ju falemnderit. Besoj se të gjitha - komisionet i kanë shqyrtuar me kohë dhe ju e dini që një javë kemi shtyrë pikërisht për shkak të nevojës së debatit rreth tyre.

Amendamentin e keni në propozimin konkret.

Kush është, që amendamenti 16, i propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, të miratohet?

Kush është kundër?

Abstenime?

Në bazë të prezencës së depuetëve, nuk kalon. Janë të pranishëm 88 në sallë.

Amendamenti 17...

Ju lutem, mund të deklarohemi edhe një herë, sepse keni kategorinë "për", kategorinë "kundër", kategorinë "abstenime". Atëherë, ju lus zoti Hyseni, do ta numërojmë secilin deputet. Nuk mund të ketë kategori tjera që s'deklarohen.

Kush është për, edhe një herë? 37.

Kush është kundër? 22 kundër.

Abstenime? Sa janë abstenime? 10.

Është një situatë interesante. Votat janë baraz në këtë moment. Jo, jo – kemi "për" baraz, "kundër" dhe "abstenime" baraz.

Në këtë rast kalon amendamenti.

Urdhëroni, sqarim.

<u>ARSIM BAJRAMI:</u>

Mendoj se duhet të jemi shum më korrektë në interpretimin e Rregullores. Neve na kujtohet në këtë Kuvend kur kemi miratuar edhe amendamente edhe ligje me numër më të vogël. Në këtë rast, shumicë relative është numri 37. 37 deputetë ishin për amendamentin. Ishin shum më pak të "abstenuar", shum më pak "kundër". Dhe, mendoj se amendamenti ka kaluar.

<u>KRYESUESI FATMIR SEJDIU:</u>

Ivanoviq, anëtar i Kryesisë, edhe një herë.

OLIVER IVANOVIĆ:

Ne ulazeći u suštinu amandmana koji gospodin, malopre dao. Ovaj amandman ne prolazi zato što nema većinu prisutnih ovde. Znači, da bi prošao, potrebno je da ima od 88 – 45 glasova. Poslovnikom o radu. Pogledajte poslovnik. Ne, ne, ja ću da donesem poslovnik da čitam. Ako hoćete da vam čitam Poslovnik, ja i to mogu samo trebam još malo do tu odem i da ga uzmem. Znači, većina glasova prisutnih ovde, mora da bude «za» da bi ovaj amandman prošao. Znači, ovaj po Poslovniku, ne prolazi.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Vazhdojmë. Ky amendament nuk kalon.

Amendamenti 18...

Hydajet votimi u krye, konstatimi u bë, të lutem! Urdhëro. Ju lutem, mund të ndalim edhe ndryshe. Personat që thejnë rregullën, mund të dalin edhe jashtë. Urdhëro, deputeti Hyseni, anëtar i Kryesisë.

HYDAJET HYSENI:

Edhe shkronja e Rregullores, edhe praktikat parlamentare, edhe praktika e këtij Kuvendi, jo më larg por sot ne, duke shqyrtuar dhe aprovuar ligjin e mëparshëm, kemi aprovuar amendament me numër më të vogël të votave "për" se sa është gjysma, po, po ashtu, dhe më shum se ata që kundërshtojnë propozimin. Dhe ky është parimi me të cilin ne kemi votuar dhe mund të votojmë. A është drejt a s'është drejt, mund të bisedojmë, por kjo është praktikë e përgjithshme parlamentare dhe kjo ë shtë R regullorja jonë. Unë m und t'i citoj nenet, por po e shoh është e paarsyeshme. Lexoni, ju lutem Rregullën 27 dhe rregullat tjera që përcaktojnë këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, ju falemnderit. Urdhëroni, kryetarja e Komisionit, edhe një herë.

STOJANKA PETKOVIĆ:

Iznenadjuje me gospodin Hiseni pošto često proziva i po pitanju procedure. Dakle, zbir glasova «za» mora da bude veći od ostalog zbira koji su «protiv» i «uzdržani»

i samo tada se donosi amandman. I to je po Poslovniku. To je po Poslovniku! Pronadjite koji je član, ali je to prosto objašnjavano. Znači zbir glasova koji su «za» mora da bude većina u odnosu na ostali zbir koji su «protiv» i koji su «suzdržani», jer ne možete da računate za glasanje samo «za» i «protiv». Računaju se i glasovi koji su «uzdržani». Hvala.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, zoti Kurteshi, nëse keni fjalën vetëm për amendament, edhe një herë, por ne jemi deklaruar dhe për këtë amendament nuk mund të jepni sqarime plotësuese. Për çka është fjala? Urdhëro.

ISMAJL KURTESHI:

Unë nuk jam ekspert i drejtësisë. Këtu kemi sekretarin që mer rrogë për atë punë. Nuk është shum me rëndësi se a do të kalojë amendamenti, atë do ta vendosë Kuvendi, por jam kundër punës me dy kute – ndonjëherë t'i lëshojmë dhe ndonjëherë mos t'i lëshojmë.

Kërkoj nga sekretari që këtu të dalë dhe të thirret në nenet e caktuara atë Rregullores së punës dhe t'na i shpjegojë edhe për këtë rast, edhe për rastet tjera - kur kalojnë amendamentet dhe kur nuk kalojnë.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Besoj se ne përfillim rregullat dhe procedurën në këtë rast.

Edhe një herë të konstatojmë. Në sallë janë gjithsej të pranishëm 91 deputetë. Gjendjen e votimeve e patë. Amendamenti nuk kalon.

Amendamenti 17, deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për amendamentin? 27.

Numëroni votat mirë, ju lutem.

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër?

Abstenime?

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për?

Kundër?

Abstenime?

Me 12 abstenime – kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? 10 abstenime.

Amendamenti kalon.

Amendamenti 21, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet krysore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër?

Abstenime? 11 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? Një.

Abstenime?

10 abstenime, një kundër – kalon amendamenti.

Amendamenti 23, kemi dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Në radhë për votim është amendamenti nën a).

Kush është për?

Kundër? 5 kundër.

Abstenime?

Kalon amendamenti me propozimin nën a).

(Prej vendi: nuk dëgjohet qartë!)

Arsim, shumica është vazhdimisht. Me marrë me numëruar secilënherë a?

Amendamenti 24, dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Kush është që amendamenti me propozimin nën a) të përkrahet?

Kush është kundër? 6 kundër.

Abstenime? 12 abstenime.

Gjithsej 18 - kalon amendamenti me propozimin nën a).

Amendamenti 25, deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për?

Numëroni votat, ju lutem. Sa janë?

Nuk kalon me këtë cilësi të votës.

Nëse dëshironi, të pyesim edhe për "kundër", por nuk kalon. 25 deputetë janë janë "për".

(Prej vendi: nuk dëgjohet qartë!)

Po mirë, është pjesa tjetër që s'e përkrah fare, ose nuk e përkrahë ose është kundër, njësoj është.

Amendamenti 26, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër?

Abstenime? 12 abstenime.

Kalon amendamenti 26.

Amendamenti 27, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër?

Abstenime? 10 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? 9 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 29, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? 9 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 30...

Urdhëro, Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI:

Në nenin 7, i cili ka të bëjë me informimin, përveç tjerash thuhet: "Personat të cilët marrin pensione të aftësisë së kufizuar, ndoshta duhet t'u nënshtrohen testimeve mjekësore në kohën dhe vendin e caktuar nga ministria apo autoritetet përkatëse". Ajo për çka jam angazhuar unë, është që: "autoritetet përkatëse do të duhej ta informojnë secilin kërkues për kohën dhe vendin e ekzaminimit së paku 10 ditë para ditës së ekzaminimit", sepse po ndodhë shpesh që ftesat të na vijnë edhe shum paskohe, prandaj unë vërtetë nuk dij cila është logjika e refuzimit të këtij amendamenti dhe vërtet do të kisha kërkuar sqarim nga ata që e kanë refuzuar.

Dhe kam edhe një vërejtje në procedim dhe numërim të votave.
Në ndonjë rast, votat numërohen në tri format, në ndonjë rast nuk numërohen, që do të thotë se kjo nuk është në rregull nga ana e kryesuesit dhe do të kërkoj që kjo të rrespektohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit.

Pra kemi amendamentin 30, të propozuar nga deputeti Ismajl Kurteshi, pa përkrahje nga Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Sqarimet shtojcë i dëgjuat nga deputeti Kurteshi.

Kush është për, që ky amendament të miratohet? 34 për.

Le të numërohen votat.

Kush është kundër? 11 janë kundër.

Abstenim?

S'është shumica e klasifikuar. Edhe një herë. Ju lus edhe një herë – deputetët le të deklarohen secili, tri kategori votimi janë: është "për", është "kundër", dhe është "abstenim". Kategori të katërtë nuk kemi në këtë rast, dhe numërimin e votave ta bëni në mënyrë korrekte.

Kush është për?

Kundër, sa janë?

Sa kemi abstenime?

Këtu kemi një problem të njësojtë, sikur në situatën e mëhershme. Nuk është siguruar shumica, në këtë rast konkret.

Edhe sipas kësaj situate, nuk është siguruar shumica për një amendament që kalon, në këtë rast konkret.

91 deputetë prezent janë në sallë, "për" janë 40, "kundër" 16 dhe "abstenime", prandaj nuk kalon.

Amendamenti 31, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër? Asnjë.

A abstenon kush? 13 abstenime.

Kalon amendamenti.

Të lutem, zoti Koci, ose deklarou "kundër" ose "për", mos të bëjmë debate tjera. Kundër s'ka asnjë tjetër. Të abstenuar janë ata që u theksuan.

Amendamenti 32, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? 15 për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 33, Koalicioni “Kthmi”, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? 14 për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 34, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për?

A ka votë kundër? Nuk ka.

Abstenime? 12 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 35, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, si dhe Koalicioni “Kthmi” me përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 2 kundër.

Abstenime? Nuk ka.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 36, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? Nuk ka.

Abstenime? 15 abstenime.

Kalon amendamenti 36.

Amendamenti 37, kemi dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Koalicioni “Kthimi”, pa përkrahje nga Komsioni i buxhetit.

Vë amendamentin nën a) në votim.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kundër? 17 kundër.

Abstenime?

Kalon amendamenti 37 me propozimin nën a).

Amendamenti 38, kemi dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për amendamentin me propozimin nën a)?

Kundër?

Abstenime?

Kalon amendamenti me propozimin nën a).

Amendamenti 39, Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Nuk kalon amendamenti.

<u>(Prej vendi: nuk dëgjohet qartë!)</u>

Po, të gjithë. Sa i kemi? Të gjithë tjerët i kemi në kategori..... por nuk kalon, mos të lodhemi më shum.

Amendamenti 40, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër?

Abstenime?

Kalon amendamenti.

Amendamenti 41, Komisioni funksional, me përkrahje nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.
Kundër? Një kundër.

Abstenime? 14 abstenime.

Kalon amendamenti 41.

Amendamenti 42, deputetja Nafije Berisha, e lpërkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

Kundër? Asnjë.

Abstenime? 16 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 43, kemi dy propozime:

a) Komisioni funksional, me përkrahje nga Komisioni i buxhetit; dhe

b) Koalicioni "Kthimi", pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Vë në votim propozimin nën a).

Kush është për? Ju falemnderit.

Kundër? 15 kundër.

Abstenime? Një abstenim.

Amendamenti kalon.

Urdhëroni, si anëtar Komisionit të legjislacionit.

ARSIM BAJRAMI:

Edhe në cilësinë e kryetarit për legjislacion, gjyqësi dhe kornizë kushtetuese, por edhe në emër të Grupit Parlamentar shpreh pakënaqësinë me mënyrën e procedimit sot. Meqenëse po procedojmë prej rasti në rast, mendoj një praktikë jo e mirë, ne jemi të gjithë dëshmitarë se kemi votuar ligje, jo vetëm amendamente, por edhe ligje pa u konstatuar se ka ekzistuar apo jo një shumicë parlamentare. Sot, para dite kishim një praktikë tjetër, pasdite një praktikë tjetër, pra një interpretim selektiv i rregullores dhe kërkoj që kjo çështje të shqyrtohet mirë dhe kërkoj, nga Sekretaria sidomos, që të jetë shum më e qartë rreth procedurave parlamentare. Në qoftë se ndjekim procedura parlamentare të votimit në një rast atëherë të jemi konsekuent dhe veprime të tilla të kemi për gjithherë. Sot patëm raste që kishim një shumicë, një shumicë relative këtu për amendamente dhe u dha interpretimi se amendamentet nuk kalojnë. Ndërkaq, këtu, me dhjetëra herë kemi pasë këtë shumicë relative dhe kemi thënë se amendamentet apo ligjet kanë kaluar. Mendoj se është ky lëshim dhe kërkoj nga Kryesia që këto mos të përsëriten, por të ndalen këto praktika të ndryshme parlamentare për shkak se, mendoj, janë të panevojshme.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mendoj se ju keni të drejtë të jipni mendimin tuaj dhe nuk qëndron krejt e vërteta ashtu.

Vazhdojmë, ju lutem. Replikë, kur ta jap fjalën. Urdhëroni... Emrin s'ta përmenda!

ARSIM BAJRAMI:

Jo, ma përmende emrin. Mendoj se në këtë rast, ka nevojë për interpretim të Rregullores. Kompetent për dhënë interpretimin e Rregullores është Komisioni për legjislacion, gjyqësi dhe kornizë kushtetuese. A kam drejtë, apo jo, unë mendoj se vetë si kryetar Komisioni do të kërkoj që në mbledhjen e parë kjo çështje të sqarohet dhe të japim interpretim për mbledhjen e ardhshme.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë, po të bëj edhe unë një replikë, sepse edhe ju s'keni të drejtë në emër të Komisionit të jepni mendim të Komisionit në këtë rast. Doni replikë prap?

ARSIM BAJRAMI:

Unë nuk dhash kurrfarë mendimi. Unë vetëm paraqita këtu shqetësime që janë mëse evidente. Këto shkelje, këto jokonsekuenca janë mëse evidente. Nuk duhet me qenë jurist, mjafton të jeshë vetëm dëgjues i thjeshtë dhe të kuptosh se diçka nuk është në rregull. Për këtë arsye, unë thash Komisioni do ta shqyrtojë këtë rast dhe në mbledhjen e ardhshme do të japim....

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Komisioni e shqyrton sipas rendit të ditës që merremi vesh në Komision.

Vazhdojmë ju lutem. Dëgjuat dhe kaluam shqyrtimin e të gjitha amendamenteve.

Më falni, Nekibe mos deshe fjalën? Urdhëroni.

NEKIBE KELMENDI:

I nderuari kryesues i mbledhjes së Kuvendit, të nderuar kolegë deputetë,

S'është rastësi ajo që thuhet se njëqind jurista – njëqindenjë mendime. Prandaj, unë dola ta them atë mendimin tim të njëqindt, për mos me thënë njëqindenjë.

Rregulla 7, pika 1 e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës thotë: "Interpretimi i Rregullores nga ana e tij bëhet nga ana e kryetarit të Kuvendit gjatë mbledhjes së Kuvendit dhe ai interpretim është përfundimtar". Prandaj, interpretimin e bën kryesuesi.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Ju lus, të vazhdojmë më tej. Bëmë shqyrtimin e të gjitha amendamenteve të dhëna në këtë Projektligj dhe tani e vëjmë në votim Projektin si tërësi.

Kush është për që ky Projektligj të miratohet.

Kush është kundër? Asnjë votë kundër.

Abstenime? 16 abstenime.

Konstatoj se Projektligji u miratua. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

---

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For..................Shumica – Vecina – Majority...........
- Kundër – Protiv – Against ...................00....
- Abstenime – Uzdrzanih – Abstaned......16....

---

Pika në vijim është - propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme.

Propozimin e keni para veti, vetëm që këtij propozimi ia shtojmë edhe pikën 4.3. - Pyetje të deputetëve.

Kryesisë së Kuvendit i kanë arritur disa pyetje dhe ato janë adresuar në rrugën e vet.

A pajtoheni që kjo pikë të shtohet? Pajtoheni. Ju falemnderit.

Me kaq përfundojmë punën e seancës.

Seanca përfundoi punën në orën 13,00.

---

E transkriptoi: fq.1-54/RT, Zyra E04, Tel.211-860